

Ku mund të kryhet aborti medikamentoz?

Sipas Ligjit për abortin, aborti medikamentoz mund të kryhet si më poshtë:

- > në ordinancat gjinekologjike deri në javën e 9 të shtatzënisë
- > në spitale deri në javën e 22 të shtatzënisë
- > deri në javën e 12 të shtatzënisë nuk ka nevojë që femrat të shtrohen në spital, në mënyrë që procesi i gjakderdhjes, përmes të cilit del jashtë fryti, mund të kryhet në kryhet në shtëpi.

> midis javës 12 dhe 22 femrat shtrohen në spital për disa ditë dhe u jepet një dozë më e madhe Misoprostol për ndërprerjen e shtatzënisë.

Më shumë informacion rreth shërbimeve të abortit medikamentoz mund të gjeni në hera.org.mk/med-abortion



Informacione të rëndësishme

> Aborti medikamentoz është i ligjshëm (Ligji për abortin 2019)

> Aborti medikamentoz lejohet deri në javën e 22-të të shtatzënisë.

> Gratë zgjedhin abortin medikamentoz sepse mendojnë se është më intim me trupin e tyre në krahasim me abortin kirurgjik.

> Nuk ka nevojë për operacion ose anestezi gjatë realizimit të abortit medikamentoz, vetëm nëse ka nevojë për një intervenim kirurgjik shtesë.

> Organizata Botërore e Shëndetësisë e rekomandon abortin medikamentoz si një metodë e sigurt për ndërprerjen e shtatzënisë.

Si funksionojnë pilulat?

> Një femër merr dy pilula për abortin medikamentoz: E para është Mifepristone dhe e dyta është Misoprostol.

> Këto pilula e ndërpresin shtatzëninë.

> Pilulat merren sipas udhëzimeve të dhëna nga mjeku.

A mund të përdor kontraceptivë pas përfundimit të abortit medikamentoz?

Ekziston mundësia që të mbetni shtatzënë përsëri menjëherë pas procedurës së abortit medikamentoz. Prandaj, sigurohuni që të përdorni kontraceptivë për të shmangur shtatzënitë e padëshiruara në të ardhmen.

> Nëse përdorni kontracepsion oral, vazhdoni me marrjen e pilulave ditën e njëjtë pas marrjes së Mifepristone (pilula e parë).

> Si metodë për kontracepsion mund t'ju vendoset spirale një javë pas përfundimit të procedurës për abortin medikamentoz, ose gjatë ekzaminimit mjekësor, ose pas ekzaminimit mjekësor, nëse shtatzënia është ndërprerë me sukses.

> Lirisht mund të përdorni prezervativë gjatë marrëdhënies së parë seksuale pas procedurës për abortin medikamentoz.



Aborti medikamentoz në Maqedoninë e Veriut: Informacion për femrat

hera.org.mk

Impressum: Österreichische Gesellschaft für Familienplanung (ÖGF), 1210 Wien, ZVR-Zahl 605062078, www.oegf.at

Grafik: Photopic e.U., Mag. art. Stefan Pommer, 3454 Sitzenberg-Reidling

Druck: online Druck GmbH, 2351 Wr. Neudorf, www.flyeralarm.at

Die ÖGF wird gefördert von: BKA: Sektion Familie und Jugend, MA57, WiGev, ÖGK, UNFPA | 1. Auflage 2022

 **Federal Ministry
Republic of Austria**
Social Affairs, Health, Care
and Consumer Protection

Die Übersetzung wurde gefördert vom
Bundesministerium für Soziales, Gesundheit,
Pflege und Konsumentenschutz



A Member Association of
 **IPPF** International
Planned Parenthood
Federation
European Network


Cila është procedura për abortin medikamentoz?

Kontrolli, këshillim dhe informacion

Gjatë vizitës së parë në spital ose në ordinancën gjinekologjike, mjeku do t'ju japë të gjitha informacionet e rëndësishme. Mjeku do t'ju bëjë disa pyetje për të vlerësuar shëndetin tuaj: ("Kur ishte perioda juaj e fundit?", "A jeni duke marrë ilaçe?", "A jeni alergjik ndaj ndonjë medikamenti?", "A keni simptoma të një infeksioneve seksualisht të transmetueshme?" etj.) Nëse pas vlerësimit mjekësor konstatohet se keni të drejtë për një abort medikamentoz, atëherë mjeku do të bëjë një eho ekzaminim për të konfirmuar shtatzëninë dhe javën e shtatzënisë.

Marrja e Mifepristone (në ordinancë gjinekologjike ose në spital)

Pilulën e parë Mifepristone e pini në ordinancën gjinekologjike. Mjeku më pas do t'ju japë një pilulë të dytë, Misoprostol, për ta marrë me vete në shtëpi. Ju këshillojmë që të vini në spital me një anëtar të familjes ose një mik të ngushtë.





Periudha e pritjes: 24-48 orë

Pasi që ta keni marrë pilulën e parë Mifepristone në ordinancën gjinekologjike ose në spital, duhet duhet të prisni 24 deri në 48 orë para se ta merrni pilulën e dytë Misoprostol. Pastaj mund të vazhdoni me rutinën tuaj të përditshme. Kërkoni mbështetje nga një mik i ngushtë ose një anëtar i familjes për atë ditë dhe nëse është e mundur për kohëzgjatjen e të gjithë procedurës. Gjakderdhja ndonjëherë mund të ndodhë në 48 orët e para, por kjo është e rrallë. Kur shkoni në spital, merrni peceta higjienike që thithin mirë lëngjet. Mund të keni ngërçe, të vjella ose diarre.

Pasi të ketë kaluar periudha e pritjes: merret Misoprostol (pilula e dytë)

Pasi të kenë kaluar 24 - 48 orë, pini pilulën e dytë Misoprostol. Deri në javën e 12 të shtatzënisë, pilula e dytë Misoprostol merret në shtëpi. Nga java e 12 deri në javën e 22 të shtatzënisë, kjo pilulë merret në spital. Marrja e Misoprostol shkakton kontraksione të mitrës. Ka ngërçe në pjesën e poshtme të barkut dhe dhimbje shpine, të ngjashme me dhimbjet menstruale. **E RËNDËSISHME:** Mund të merrni një pilulë për zvogëlimin e dhimbjeve si masë parandaluese. Por duhet ta bëni këtë në konsultim me mjekun.



Fillimi i gjakderdhjes

Gjakderdhja e abortit fillon disa orë pas marrjes së pilulës së dytë (Misoprostol). Mund të jetë e madhe për 2-3 orë. Merrni mjaft peceta higjienike! Gjakderdhja mund të zgjasë nga 7 deri në 12 ditë dhe me kalimin e kohës bëhet më e lehtë. Edhe pse mund të keni gjakderdhje më shumë se zakonisht, nuk është e rrezikshme. Shumë rrallë, mund të shihni një mpiksje gjaku në gjakderdhje. **E RËNDËSISHME:** Mos përdorni tamponë në vend të pecetave higjienike.

Vizitë kontrolli pas 14 ditësh

Shkoni për një ekzaminim 14 ditë pas marrjes së Misoprostol (pilulës së dytë). Kjo është shumë e rëndësishme. Do të bëhet një eho ekzaminim për të përcaktuar nëse shtatzënia është ndërprerë. Në 95-98% të rasteve, aborti medikamentoz është i suksesshëm. Nëse shtatzënia nuk ndërpritet, atëherë ata mund t'ju japin një dozë shtesë të Misoprostol ose t'ju referojnë për një abort kirurgjikal që të hiqet tërësisht fryti dhe të ndërpritet shtatzënia.



Cilat janë efektet e padëshiruara e mundshme prej pilulave për abortin medikamentoz?

> ngërçe, të vjella, të përziera ose diarre;

> dhimbje koke, djersitje, marramendje dhe ndjenjë si të jeni e sëmurë;

> dhimbje në shpinë dhe në fund të barkut;

> alergjitë dhe skuqjet e lëkurës janë të rralla;

Menjëherë kontaktoni mjekun tuaj, nëse:

> Nuk keni gjakderdhje ose keni pak gjakderdhje brenda 24 orëve nga marrja e Misoprostol (pilulës së dytë);

> Nëse keni dhimbje shumë të forta në pjesën e poshtme të barkut edhe pse keni marrë një qetësues;

> Nëse keni gjakderdhje të madhe - më shumë se 4 peceta të trasha higjienike në 2 orë;

> Nëse keni temperaturë ose ethe;

> Nëse pas 6 javësh ende nuk ju kanë ardhur menstruacionet.